



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 149 Akti**

**Nr. 157 Vendimi**

**Tiranë, më 14.6.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Pamela Qirko**  
**Brunilda Bekteshi**  
**Roland Ilia**

**Kryesuese**  
**Anëtare**  
**Relator**

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 13 qershor 2019, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Enkeleda Millonai**, me detyrë drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar paragrafi 5 të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 15.5.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.\*\*\*, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Pamela Qirko dhe Brunilda Bektshi. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues në datën 24.5.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave ( në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai.*

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2019.

11. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës në datën 29.5.2019, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit në datën 29.5.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 30.5.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 4.6.2019.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e saj në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet

e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 6.6.2019, vendosi të ftojë znj. Enkeleda Millonai, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 6.6.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 13.6.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani të edhe vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Enkeleda Millonai ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj

për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017<sup>[1]</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së saj dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

---

<sup>[1]</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## **2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimi i deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, nr. indeksi \*\*\*, datë 26.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2008 – 2016 , në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

### **Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:**

- ❖ Apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi 94.5 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqe e brendshme 80.8 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përbashkët 13.7 m<sup>2</sup>, në katin e pestë, Komuna \*\*\*, Tiranë. Viti i krijimit: 2015.

Për këtë pasuri është lidhur kontratë porosie me nr. \*\*\*, datë 4.12.2015, në vlerën 45,000 euro. Nga kjo shumë është paguar 10,000 euro, të konvertuara në vlerën prej 1,379,100 lekësh, ndërsa pjesa tjetër prej 35,000 eurosh, do të likuidohet në momentin e hipotekimit të godinës dhe lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes. Pjesa takuese: 100 %.

### *Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Nga të ardhurat e ligjshme, të kursyera vit pas viti, kryesisht nga paga, shpërblimet nga Shkolla e Magjistraturës dhe shitja e makinës në datën 25.9.2015.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur, me përgjigjen e DPPPP-së dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë (nuk është nënshkruar kontrata e shitblerjes).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga hetimet e kryera nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë porosie nr. \*\*\*, në datën 4.12.2015, për blerje apartamenti me shoqërinë “\*\*\*”. Objekti i kontratës është blerja e një apartamenti me sip. ndërtimi 94.5 m<sup>2</sup>, kati i pestë, Komuna \*\*\*, Tiranë. Vlera e apartamentit sipas kontratës është 45,000 euro dhe çmimi do likuidohet:

- Vlera prej 10,000 eurosh është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës në llogarinë e shoqërisë;
- Diferenca prej 35,000 eurosh do të likuidohet në momentin e hipotekimit të godinës dhe lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes.

Sipas shkresës së “Credins Bank”, datë 4.12.2015, rezultoi se nga llogaria e subjektit ka kaluar në favor të shoqërisë “\*\*\*”, shuma prej 1,379,100 lekësh, bazuar në kontratën nr. \*\*. Nuk rezultoi të jetë lidhur kontrata përfundimtare e shitblerjes nga ana e subjektit për këtë pasuri.

Lidhur me disa gjetje të Komisionit për këtë pasuri është pyetur subjekti në lidhje me vendosjen e këtyre termave kontraktorë ku pjesa më e madhe në vlerën prej 35,000 eurosh, do paguhej në momentin e hipotekimit të godinës dhe nëse ishte regjistruar kjo godinë dhe a ishte lidhur kontrata e shitblerjes për këtë apartament.

Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e tij ka deklaruar se ka qenë në pamundësi që të shlyente të gjithë vlerën e apartamentit apo të paguante ndonjë vlerë të konsiderueshme për shlyerjen e tij. Për këtë arsye në momentin e lidhjes së kontratës, subjekti ka paguar shumën prej 10,000 eurosh, ndërsa pjesën tjetër do ta siguronte nëpërmjet një kredie, e cila mund të merrej pas regjistrimit të pallatit. *Pallati nuk është regjistruar ende dhe nuk është lidhur as kontrata e shitblerjes, duke mos u bërë e mundur as marrja e kredisë dhe as shlyerja e pjesës së mbetur të vlerës, në shumën 35.000 euro.*

### **Arsyetimi ligjor**

Subjekti i rivlerësimit e ka pasqyruar saktë këtë pasuri si në deklaratën “Vetting”, ashtu dhe në deklaratat periodike vjetore. Burimet e ligjshme financiare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie deri më sot janë deklaruar saktë nga subjekti dhe për këtë Komisioni nuk konstatoi parregullsi.

Të ardhura për pagesën e kryer të këstit të parë janë verifikuar nga Komisioni ku ka rezultuar se shuma prej 1,379,100 lekësh është përballuar nga llogaria bankare që ka pasur subjekti i rivlerësimit, shumë e cila ka kaluar nëpërmjet transfertës bankare datë 4.12.2015, te pala shitëse. Veprimet financiare të kryera mbi këtë pasuri janë pasqyruar në analizën financiare.

Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie apartament nuk u konstatuan problematika, pasi çmimi/m<sup>2</sup>, sipas kontratës së porosisë, rezulton në vlerën prej 476 eurosh (rreth 60,000

lekë/m<sup>2</sup>). Referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4 të vitit 2015, kosto mesatare e ndërtimit për qytetin e Tiranës është në vlerën 39,193 lekë/m<sup>2</sup>.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë për veprimet e kryera bazuar në kontratën e porosisë për përfitimin e kësaj pasurie të paluajtshme, si dhe ka pasur burime financiare të ligjshme.

- ❖ Automjet me targë AA \*\*\* NK, tip “Opel Meriva”, viti i prodhimit 2004, blerë me kontratën e shitblerjes së automjetit të datës 17.3.2016. Vlera e pasurisë: 2,500 euro. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Nga të ardhurat e ligjshme të kursyera vit pas viti, kryesisht nga paga, shpërblimet nga puna dhe shpërblimet nga Shkolla e Magjistraturës.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR-së.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2016, DPSHTRR-ja ka dërguar të dhënat për mjetin me targë AA \*\*\* NK, në pronësi të subjektit. Sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.3.2016, subjekti ka blerë automjetin tip “Opel Meriva”, me vlerë 2,500 euro, nga shtetasja J. V. Ky automjet është blerë më parë nga shtetasja J.V., në vlerën 900 euro, ku janë paguar dhe detyrimet doganore në datën 19.2.2016.

Pra, pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se vlera e blerjes së këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit është më e lartë se vlera e blerjes nga shitësja J.V.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratën periodike për vitin 2016: “*Automjet me targa AA \*\*\* NK, “Opel Meriva”, viti i prodhimit 2004 në vlerën 2,500 euro, nga të ardhura të ligjshme, nga paga, shpërblimet nga puna, nga Shkolla e Magjistraturës*”.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni vlerësoi se nuk kanë lindur dyshime mbi këtë automjet dhe se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

- ❖ Depozitë plus me nr. \*\*\*, pranë “Credins Bank”, e krijuar me qëllim kursimi në monedhën lekë. Viti i krijimit: 2012. Në datën 21.1.2017, gjendja në këtë llogari është në vlerën 100,686 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:*

Të ardhurat nga llogaria e pagës, shpërblime nga puna, interesa kreditore, të ardhura të ligjshme etj., të cituara në deklaratën “Vetting”.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen nga “Credins Bank”.



### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Bazuar në ekstraktin e “Credins Bank”, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka depozitë bankare dhe ka kryer veprime dhe transaksione të ndryshme në këtë bankë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 21.01.2017 është në vlerën 100,686.61 lekë. Burimi për krijimin e kësaj depozite të deklaruar nga subjekti dhe verifikuar nga Komisioni, janë të ardhurat e përfituar nga marrëdhëniet e punës së subjektit dhe burimet e tjera të ligjshme. Veprimet financiare për këtë llogari të kryera nga subjekti ndër vite janë përfshirë në analizën financiare. Kjo llogari është krijuar në formën e depozitës bankare dhe ndryshimet e saj janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe në deklaratat periodike vjetore.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të gjendjes së likuiditetit në deklaratën “Vetting” për këtë depozitë bankare.

- ❖ Depozitë me afat 12 mujor, pranë “Credins Bank”, nr. \*\*\*, në monedhën lekë. Viti i krijimit: 2013. Aktualisht, gjendja e saj deri në datën 21.1.2017 është 55,690 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Nga të ardhurat e ligjshme, të kursyera viti pas viti, kryesisht nga paga, shpërblimet nga Shkolla e Magjistraturës, interesa kreditore.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen nga “Credins Bank”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Bazuar në shkresën e “Credins Bank”, nr. \*\*\*, datë 15.8.2017, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka krijuar një depozitë bankare me gjendje në vlerën 55,690 lekë. Rezultoi se kjo është llogari depozite e krijuar nga të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI.

Veprimet financiare për këtë llogari janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni konstatoi se për këtë depozitë bankare subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të gjendjes së likuiditetit në deklaratën “Vetting”.

- ❖ Llogaria e pagës, në “Credins Bank”, nr. \*\*\*, llogari e pafrytshme. Gjendja e saj aktuale në datën 24.1.2017 është në vlerën 4,218 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Nga prokuroria, hidhet paga dhe shpërblimet, shpërblimet nga seminarët, Shkolla e Magjistraturës, të ardhura të ligjshme.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen nga “Credins Bank”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Sipas dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank” dhe të administruar nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka llogari rrjedhëse pranë kësaj banke në gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 4,218 lekë.

Rezultoi se kjo është llogari page e subjektit. Veprimet financiare për këtë llogari janë përfshirë në analizën financiare. Kjo llogari rrjedhëse e pagës është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratat periodike vjetore.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të gjendjes së likuiditetit të kësaj llogarie bankare, në deklaratën “Vetting”.

- ❖ Llogari rrjedhëse në lekë, në “Raiffeisen Bank”, nr. \*\*\*. Viti i krijimit: 2013. Gjendja në datën 23.1.2017 është në vlerën 13 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Të ardhura nga punësimi si pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës si lehtësuese.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen nga “Raiffeisen Bank”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Sipas dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 13 lekë.

Në këtë llogari, pas verifikimit nga Komisioni, rezultoi se janë kryer transaksione nga subjekti i rivlerësimit me burim të ardhurat si pedagoge e Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Veprimet financiare të kryera në këtë llogari ndër vite janë përfshirë në analizën financiare.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të gjendjes së likuiditetit në deklaratën “Vetting”.

- ❖ Gjendje *cash* në shtëpi, shuma prej 50,000 lekësh.

*Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”*

Kursime nga paga e vitit 2016. Pjesa takuese: 100 %.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin i cili justifikon gjendjen e deklaruar prej tij.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në deklaratën periodike për vitin 2016 u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje *cash* në shtëpi në shumën 50,000 lekë, e krijuar nga kursime nga paga”.

Bazuar në analizën financiare Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të kursyer shumë prej 50,000 lekësh në raport me të ardhurat e krijuara pas zbritjes së të gjitha shpenzimeve të kryera dhe ndryshimit të likuiditeteve për vitin 2016.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni ka konstatuar se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë likuiditet dhe se ka pasur mundësi për të krijuar gjendjen *cash* në shumë e deklaruar.

❖ Pasuria automjet e blerë në vitin 2011.

Komisioni verifikoi deklaramin e subjektit lidhur me automjetin e blerë në vitin 2011, në vlerën 1,500 euro dhe shitur në vitin 2015 në vlerën 180,000 lekë.

Sipas dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë një automjet në vitin 2011 në vlerën prej 1,500 eurosh.

Komisioni konstatoi se këtë pasuri subjekti e ka deklaruar në deklaramin periodike për vitin 2011, si pasuri e blerë në vlerën 1,500 euro, por nuk ka deklaruar vlerën e plotë pasi nuk ka përfshirë koston dhe shpenzimet e transportit nga shteti i blerjes Gjermania, si dhe detyrimet doganore në vlerën prej 68,617 lekë.

Vlera e blerjes së automjetit dhe shpenzimet e tjera pas përgjigjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit janë përfshirë në analizën financiare.

Për këto konstatime të Komisionit, iu kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit.

Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyestëorit sqaron se *në kohën që ka plotësuar deklaramin për vitin 2011, në datën 19.3.2012, nuk ka qenë e parashikuar pasqyrimi i shpenzimeve të kryera për këtë automjet. Qëllimi sipas subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë asnjëherë mosdeklarimi apo fshehja e shpenzimeve të kryera, por sipas vlerësimit tim, kam respektuar kërkesat e ligjit, duke menduar se duhej deklaruar çmimi i blerjes dhe shpenzimet e tjera kualifikoheshin si shpenzim dhe nuk përfshiheshin në çmim. Megjithatë, duke vlerësuar gjetjen e Komisionit menjëherë me paraqitjen e kërkesës nga ky i fundit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e kryera për këtë automjet.*

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Pas përgjigjes së dërguar nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematikë lidhur me këtë pasuri të blerë, shitur dhe deklaruar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit. Vlera e plotë e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie është llogaritur në analizën financiare të vitit përkatës.

❖ Pasuria banesë e vendosur si adresë banimi nga subjekti i rivlerësimit

Pas konstatimeve të kryera nga Komisioni gjatë fazës së hetimit është pyetur subjekti i rivlerësimit për banesën e vendosur si adresë në deklaramat periodike vjetore, Rr. “\*\*\*\*”, Njësia Administrative Nr. \*\*\*.

I pyetur nga Komisioni subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *në këtë adresë është regjistruar, si pasojë e regjistrimit të familjes sime pranë kësaj zyre të gjendjes civile. Gjithashtu, më tutje*

*ajo ka sqarua se nuk ka jetuar ndonjëherë në këtë adresë dhe se nuk ka pasur dijeni në lidhje me pronarin e kësaj banese, si dhe nuk ka kryer shpenzime në lidhje me atë pasuri<sup>1</sup>.*

### **Në përfundim konstatohet se:**

Pas përgjigjes së subjektit Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me deklaratimet e saj për adresën e përmendur në deklaratat periodike.

#### ❖ Pasuria banesë e përdorur ndër vite nga subjekti i rivlerësimit

Komisioni, pas konstatimeve për pasurinë e përdorur ndër vite, pyeti subjektin e rivlerësimit për të dokumentuar burimin e blerjes së pasurisë ku kishte jetuar me prindërit në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *Banimi në këtë adresë ka filluar para se unë të dekretohesha si prokurore, pra në vitin 2006. Kjo banesë është blerë nga prindërit bashkë me vëllain tim dhe bashkëjetuesen dhe më pas bashkëshorten e tij, me të ardhura nga emigracioni*. Subjekti i rivlerësimit deklaroi gjithashtu se: *“Shlyerja e banesës është bërë nga të gjithë familjarët e mi të cituar më sipër, në vitin 2007, ndërkohë që unë jam dekretuar si prokurore për të kryer vitin e stazhit në nëntor 2008, pra, rreth më tepër se një vit para se të dekretohesha si prokurore*”. Subjekti sqaroi se nuk ka asnjë të drejtë pronësie mbi këtë apartament, pasi nuk ka kontribuar për blerjen e tij.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaratim të subjektit të rivlerësimit. Kjo pasuri rezultoi e blerë nga babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, para periudhës së subjektit të rivlerësimit të emërohej si prokurore. Gjithashtu, janë verifikuar dhe mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga babai dhe vëllai i subjektit dhe nuk janë konstatuar problematika.

#### ❖ Pasuritë e luajtshme të përdorura për udhëtime jashtë vendit nga subjekti

Komisioni bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte udhëtuar disa herë jashtë vendit me automjete të ndryshme. Për këtë është pyetur subjekti lidhur me udhëtimet jashtë vendit dhe përdorimin e mjeteve; me targën AC \*\*\* T në mars 2018, mjeti me targë AA \*\*\* FI në janar 2016, dhe mjeti me targë VIEVK\*\*\* në nëntor 2011.

Për këtë çështje në datë 15.5.2019, subjekti ka kthyer përgjigje duke deklaruar<sup>2</sup> se:

- *Ka udhëtuar me mjetin me targa AC \*\*\* T në muajin mars të vitit 2018, për shkak të pjesëmarrjes në një trajnim në Malin e Zi. Ky automjet është vënë në dispozicion nga organizatorët e trajnimit, projekti \*\*\*.*
- *Mjeti me targa AA \*\*\* FI është në pronësi të vëllait të subjektit, z. F.M., dhe ka udhëtuar në drejtim të Greqisë për të takuar babanë.*
- *Automjeti me targa VIEËK \*\*\* është automjeti “Benz”, që subjekti deklaroi se e ka blerë në vitin 2011, i targuar në vijim me targa AA \*\*\* CP, dhe i deklaruar në deklaratat përkatëse të pasurisë.*

<sup>1</sup> Shikoni përgjigjen e subjektit, të datës 24.3.2019 në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup> Shikoni përgjigjen e subjektit të datës 15.5.2019, në dosjen e Komisionit.

### Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me automjetet me të cilat kishte udhëtuar subjekti i rivlerësimit dhe kontaktet me personat pronar dhe përdorues të këtyre mjeteve.

### Analiza financiare, periudha 2008 – 2016

VITI	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
2008	505 143	-126 246	31 005	-157 251	141 935	520 459
2009	916 814	516 356	-31 005	547 361	139 926	229 527
2010	938 400	-216 733	0	-216 733	143 920	1 011 213
2011	952 526	306 923	0	306 923	143 920	501 683
2012	935 052	634 817	300 000	334 817	233 332	366 903
2013	920 478	370 428	-300 000	670 428	145 022	105 028
2014	1 474 530	101 730	0	101 730	405 692	967 108
2015	1 428 691	5 025 906	4 815 150	210 756	344 352	873 583
2016	1 618 946	-50 635	0	-50 635	242 992	1 426 589
<b>TOTAL</b>	<b>9 690 580,27</b>	<b>6 562 545,93</b>	<b>4 815 150,00</b>	<b>1 747 395,93</b>	<b>1 941 090,77</b>	

### Në përfundim konstatohet se:

Bazuar në analizën financiare Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme për periudhën 2008 – 2016 ku ka ushtruar funksionet e prokurores.

*Nga administrimi i shkresave dhe provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer, nuk rezultuan indice lidhur me vlerësime të fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë.*

## B. NË LIDHJE ME KONTROLLIN E FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së , nr. \*\*\*, datë 26.12.2018, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: ***“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai”***.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

## C. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, është përgatitur, nga KLP-ja, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje/praktika penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar dhe relatori i cili ka paraqitur përpara trupit gjykues të Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai.

### ❖ PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

1. **Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 30.3.2015**, i regjistruar për veprën penale: “*Fshehje e të ardhurave*”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit S.Ç.
2. **Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 17.8.2015**, i regjistruar për veprën penale: “*Vjedhje*” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.
3. **Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 14.1.2016**, i regjistruar për veprën penale: “*shpërdorim detyrë*” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
4. **Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 4.4.2014**, i regjistruar për veprën penale: “*falsifikim të i dokumenteve shkollore*” parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal.
5. **Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 27.11.2014**, i regjistruar për veprën penale: “*shpërdorim detyrë*” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional për 5 çështjet e shortuara për subjektin e rivlerësimit.

Trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit.

### ❖ TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe nga burimet në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezulton që subjekti, znj. Enkeleda Millonai:

- të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer;

- të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve, në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në veprime të dyshimta;

- të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
- të ketë pasur ndaj saj procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme;
- subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, për vitin 2014, 2015 dhe 2016, ka vlerësimin “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm.

## ❖ ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) nga formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti; (ii) nga pesë dosjet e përzgjedhura me short; dhe (iii) nga të dhënat prej burimeve arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

### 1. Aftësitë profesionale

#### a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, ka aftësi sa i takon interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi elementeve të veprës penale në përputhje me provat, për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore.

Ajo respekton parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej saj në respektim të dispozitave procedurale penale dhe akteve nënligjore.

#### b) Arsytimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Aktet e përpiluara prej saj konceptohen të ndara në pjesë, të qarta, të identifikueshme me emërtimin përkatës. Nga aktet dhe dosjet e vëzhguara konstatohet se vendimmarrjet e saj kanë ngelur në fuqi.

Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### 2. Aftësitë organizative

#### a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, gjatë periudhës tetor 2013 – prill 2014 ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Gjatë periudhës prill 2014 – shtator 2015, ka ushtruar funksionin e drejtueses së Njësisë së Përbashkët Hetimore Kundër Krimin Ekonomik dhe të zëvendës drejtueses në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Në periudhën 11.9.2015 deri më 31.12.2015, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, është komanduar në detyrën e prokurores në Njësinë e Hetimit të Korrupsionit dhe të Pasurisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Në periudhën 15.3.2016 deri më 16.11.2016, subjekti i

rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, është komanduar në detyrën e zëvendësdrejtueses në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Në vijim, kjo prokurorë është caktuar si zëvendësdrejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Ajo ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short rezultoi se qëndrimi i saj është shprehur brenda afateve, sipas kërkesave të akteve nënligjore dhe ligjore. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, është efiçente dhe efektive. Në efektivitetin dhe efiçencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat administrative/drejtuese

Prokurorja Enkeleda Millonai, gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë në pozicionin e zëvendësdrejtueses dhe drejtueses së Njesisë së Përbashkët Hetimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Nga vlerësimet e punës së subjektit Enkeleda Millonai për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezultoi se ajo është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale që ajo ka treguar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, vlerësohet se ka bërë një administrim të rregullt të akteve që janë përpiluar apo që janë administruar prej saj në dosje gjatë hetimit. Përgjithësisht, shkresat me të cilat kërkohen informacione nga institucionet e ndryshme gjenden të bashkëlidhura me përgjigjen e këtyre institucioneve, ashtu si edhe vendimmarrjet e këqyrjeve dhe të sekuestrimeve, si dhe veprime të tjera hetimore. Aktet renditen sipas logjikës së hetimit, duke e bërë lehtësisht të aksesueshme dosjen. Për sa i përket renditjes së akteve respektohen dispozitat procedurale penale.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të një prokurori.

a) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, dhe nga dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

b) Paanësia

Nga dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit. Në asnjërën prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.



Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

##### a) Aftësitë e komunikimit

Në dosjet e vëzhguara në format letër dhe në dokumentet e dorëzuara prej subjektit të rivlerësimit, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

##### b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentet ligjore dhe në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, ka aftësi për të bashkëpunuar me oficerët e policisë gjyqësore, kolegët, ndërkohë që nuk ka të dhëna në lidhje me bashkëpunimin me administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

##### c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Enkeleda Millonai, rezultoi se është angazhuar në aktivitete që i kanë ofruar njohuri në fusha të ndryshme të së drejtës, duke u trajnuar në vazhdimësi si në kuadrin e Programit të Trajnimit Vazhdues për prokurorët dhe për gjyqtarët të Shkollës së Magjistraturës, ashtu edhe nga organizma të tjerë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Trajnimet e saj konstatohet se janë kryesisht në fushën e luftës ndaj krimit ekonomik dhe korrupsionit.

#### **D. DENONCIMET**

Për subjektin e rivlerësimit pranë Komisionit janë paraqitur tetë denoncime si më poshtë:

1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2019 i shtetasit **P.S.** Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për ngritje akuze e padrejtë të pabazuar në fakte.

2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, i shtetasit **A.C.** Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje të etikës profesionale, për paaftësi profesionale dhe për korrupsion.

3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2018, i shtetasit **J.V.** Denoncuesi ka bërë denoncim për disa subjekte dhe ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit, për refuzim të ushtrimit të ndjekjes penale ndaj gjyqtarëve.

4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2018, i shtetasit **A.B.** Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për veprime në kundërshtim me ligjin.

5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2017, i shtetasit **B.I.** Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për ngritje akuze të padrejtë e të pabazuar në fakte.

6. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2018, i shtetasit **A.E.** Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre.

7. Denoncimi i shtetasit **A.L.**, paraqitur me *ema-il* në Komision në datën 3.3.2019. Denoncuesi e ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore.

8. Denoncimi i shtetasit **M.H**, paraqitur në Komision përmes Komisionerit Publikë në datën 4.4.2019.

Pasi u analizuan nga Komisioni, në lidhje me këto denoncime subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti paraqiti shpjegimet e veta të detajuara, si dhe procedurat që ka ndjekur lidhur me çështjet e denoncuara si më poshtë.

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit P.S.

*Në datën 20.9.2012 është regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasit P.S., i akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”. Pas kryerjes së hetimeve u konstatua se në komunën Gjinar ishin kryer ndërtime të paligjshme, se këto ndërtime ishin konstatuar nga shtetasi P. S., me detyrë shef i Urbanistikës në këtë komunë, i cili njëkohësisht ushtronte edhe detyrën e kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Gjinar. Në akuzën për gjykim janë përcaktuar shkeljet e kryera nga i pandehuri, duke cituar dispozitat përkatëse të kuadrit ligjor në fushën e urbanistikës, të inspektimit të ndërtimeve, të organizimit dhe të funksionimit të qeverisjes vendore apo aktet nënligjore përkatëse.*

*Hetimet e kryera dhe akuza e ngritur në vijim kanë qenë të drejta dhe të mbështetura në prova e në ligj, rezultat i një pune të kujdesshme hetimore dhe i një shqyrtimi të hollësishëm të legjislacionit përkatës në fushën e urbanistikës, inspektimit të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes vendore, duke e ndërthurur më pas me legjislacionin penal. Pretendimet e ngritura nga shtetasi P.S., janë të pabazuara në prova e në ligj. Ky fakt pasqyrohet edhe nga vendimi nr. \*\*\*, datë 8.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit A.C.

*Veprimet hetimore për këtë çështje janë kryer deri në datën 30.10.2015, pasi më pas drejtuesi i Prokurorisë e ka zëvendësuar prokurorin e çështjes, i cili ka vendosur pushimin e çështjes në datën 16.12.2015.*

*Kjo çështje është hetuar me seriozitet, duke i kushtuar rëndësi pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi, ku janë kryer veprime të shumta hetimore me qëllim zbardhjen e ngjarjes.*

*Pretendimet që ngrihen nga shtetasi A.C., janë të pabaza dhe të pambështetura në aktet e paraqitura apo në ligj. Nuk rezulton të jetë cenuar të drejtat e palëve, nuk është paraqitur ankimi në gjykatë mbi këtë vendimmarrje të prokurorisë, si dhe për këtë vendim nuk figuron të jetë dhënë ndonjë vendim shfuqizimi nga prokurori më i lartë.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit J.V.

*Kallëzimi penal i bërë nga ky shtetas është regjistruar me nr. \*\*\*, datë 5.11.2014, bazuar në nenin 248 të Kodit Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për të është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 7.11.2014, nga prokurori K. A. Ky vendim nuk rezulton të jetë shfuqizuar.*

*Siç mund të shihen, pretendimet e ankuesit në lidhje me subjektin e rivlerësimit janë të pavërteta dhe të pabazuara, pasi vendimmarrja dhe verifikimet përkatëse në kuadër të këtij kallëzimi penal i përkasin një prokurori tjetër.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit A.B.,:

*Në datën 19.12.2013 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 19.12.2013, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të personit nën hetim T. H.*

*Me marrjen e materialit në dorëzim janë studiuar me kujdes të gjitha provat e administruara dhe janë analizuar me kujdes të gjitha pretendimet e ngritura nga kallëzuesit, të gjitha momentet që vlerësoheshin dhe pretendoheshin se ishin kryer në shkelje të ligjit. Kjo gjë mund të konstatohet lehtësisht në arsyetimin e vendimit të pushimit. Për sa i përket afatit të hetimit për një procedim penal se ai nuk është individual sipas prokurorit që e ndjek atë por është një për tërësinë e procedimit penal.*

*Hetimet kanë zgjatur një vit e pesë muaj dhe nga data e regjistrimit të emrit të shtetasit T. H. si person nën hetim dhjetë muaj. Pas studimit të hollësishëm të të gjitha akteve të gjendura në dosje është krijuar bindja se kishte prova të plota për të konkluduar me vendimmarrje. Pretendimet e ankuesit se u janë rrëzuar kërkesat për marrje në pyetje nuk qëndrojnë. Në tërësi pretendimet e ngritura nga ankuesi janë të pabazuara. Vendimmarrja nuk është ankimuar dhe i është nënshtruar kontrollit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij, duke u lënë përfundimisht në fuqi.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit B.I.

*Në datën 7.10.2014 është regjistruar procedimi penal për veprat penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Prokurori i ngarkuar me ushtrimin e ndjekjes penale ka qenë prokurori B.M., i cili e ka hetuar dhe e ka dërguar për gjykim këtë çështje. Përgjatë procesit gjyqësor, specifikisht për shkak të kallëzimeve të shumta që ky qytetar ka paraqitur dhe vazhdon të paraqesë ndaj prokurorëve, është proceduar në disa raste me zëvendësimin e tyre.*

*Ndër vite nga ky shtetas janë paraqitur kërkesa të shumta për zëvendësimin e prokurorëve, nga të cilat disa janë pranuar e disa jo, pasndjekur me një valë kallëzimesh ndaj prokurorëve që caktoheshin për të përfaqësuar këtë çështje në gjykatë. Sidoqoftë, të gjitha pretendimet që ngre ky shtetas lidhen me pakënaqësitë e tij për arrestimin në kuadër të procedimit penal të mësipërm dhe dërgimin për gjykim të çështjes në ngarkim të tij, gjë që rezulton nga kallëzimet e shumta të tij për çdo prokuror që merr përsipër përfaqësimin e çështjes në ngarkim të tij.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit A.E.

*Për këtë çështje është treguar angazhim dhe përkushtim maksimal, duke pasur parasysh faktin se ankuesi kishte pretendime të shumta që shtriheshin në periudha të gjata kohore të kaluara, se vazhdimisht ishin kryer hetime për pretendimet e tij, ishte disponuar për këto pretendime me vendime si nga prokuroria, ashtu edhe nga gjykata.*

*Pas kryerjes së hetimeve – të cilat kanë qenë të shumta – është disponuar pushimi i hetimeve për procedimin penal të vitit 2015, pushimi i pjesshëm i hetimeve për procedimin penal të vitit 2016, si dhe dërgimi për gjykim i procedimit penal nr. \*\*\* i vitit 2016. Pushimi i çështjeve është vendosur ndër të tjera për shkak të përballjes me institutin e parashkrimit në respektim të nenit 66 të Kodit Penal.*

*Ndërkohë, janë kryer dhe shumë veprime procedurale për këtë çështje<sup>3</sup>.*

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit A.L.

*Regjistrimi i procedimit penal ndaj këtij shtetasi është bërë bazuar në të dhënat e ofruara nëpërmjet referimit të kryer nga policia gjyqësore në Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA), në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pasi dyshohej se punonjësi i policisë, z. A.L., është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme dhe akte korruptuese.*

*Të dhënat që e krijojnë dyshimin mbi implikimin e punonjësit të policisë në veprimtari të kundërligjshme janë pasqyruar në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal datë 12.5.2015.*

*Pretendimi i ngritur nga ankuesi se nuk janë kryer veprime për të krijuar dyshimin e arsyeshëm nga data 11.9.2014 deri në datën 3.6.2015 nuk qëndron. Bëhet fjalë për dy procedime penale të ndryshme, ku procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2015 është regjistruar pas referimit nga SHÇBA-ja. Lidhur me pretendimet se nuk është kryer asnjë veprim hetimor – qoftë edhe një shkresë hipotekës – nuk rezultojnë të vërteta.*

Lidhur me veprimet e kryera, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion provues në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>4</sup>.

➤ Lidhur me denoncimin e shtetasit M.H.:

*Pretendimet e ngritura në tërësi nga ky shtetas kërkojnë të denigrojnë figurën, si në aspektin personal, ashtu edhe në atë profesional. Përveçse fyese, ato nuk përmbajnë asgjë të vërtetë, janë të rreme dhe të pabaza.*

*Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014. Në kuadrin e këtij procedimi penal është ushtruar ndjekja penale, duke u kryer veprime të shumta hetimore dhe, në respektim të ligjit, në përfundim është vendosur pushimi i çështjes penale. Janë kryer veprimet e duhura hetimore: është kryer një hetim kompleks dhe i është dhënë zgjidhje ligjore dhe i mbështetur mbi prova. Janë administruar të dhënat mbi statusin juridik të subjekteve tregtare, kontrollet e kryera nga organet tatimore, janë kryer eksperimente hetimore, marrje në pyetje e shtetasve të ndryshëm, administrim i të gjithë provave të mundshme, koordinime të pretendimeve që ngriheshin nga organet tatimore me vetë kontrollet e realizuara prej tyre dhe gjendjen në fakt, janë administruar aktet e procedurave administrative, janë administruar të dhëna nga subjektet tregtare, është kërkuar informacion në bankat e nivelit të dytë, janë marrë vendime për kryerje ekspertimi kontabël, si dhe janë administruar akte të gjykatës etj.*

*Në përfundim të hetimit është vendosur dhe konkluduar me vendim pushimi. Kjo çështje i është nënshtruar kontrollit të prokurorit më të lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe vendimi është gjetur i drejtë, i bazuar në ligj e në prova, është rrjedhojë e kuptimit dhe i zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural penal, sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2015.*

*Në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është ushtruar ndjekja penale në respektim të ligjit. Janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes, duke administruar praktikat përkatëse të prokurimit, këqyrje, janë marrë vendime ekspertimi, pyetje e shtetasve*

<sup>3</sup> Shikoni përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit.

<sup>4</sup> Shikoni përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura në rezultatet e hetimit.

*të ndryshëm. Për këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur deklarinimin fajtorë të të pandehurve duke urdhëruar më pas pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim në respektim të nenit 59 të Kodit Penal. Ky vendim rezulton të jetë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.4.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

Komisioni, pas analizimit të përgjigjeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se nuk rezultojnë indice apo prova bazuar në denoncimet, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

➤ Denoncim i shtetases D.P.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2018, Komisioni kërkoi informacion lidhur me dy çështje të ndjekura nga Prokuroria Elbasan. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka dërguar vendimet lidhur me dy procedime penale. Në njërin nga procedimet penale të ndjekur nga subjekti rezultoi:

Në datën 13.1.2012 është paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan shtetësja D.P, e cila ka bërë kallëzim penal për veprën penale “falsifikim dokumentesh”. Nga subjekti i rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2012, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Objekti i hetimit dhe i kallëzimit penal ishte pretendimi i falsifikimit të vendimit gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me trup gjykues në përbërje të të cilit ishte edhe gjyqtarja P.F. Në përfundim të hetimit, në datën 23.4.2012, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2012 dhe se kundër vendimit mund të bëhej ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Duket se ky vendim i dhënë nga subjekti binte në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale. Konkretisht, në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet:

*Neni 78*

*Kompetenca për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*

*1. Procedimet, në të cilat një gjyqtar ose prokuror merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, që sipas normave të këtij kreu do të ishin në kompetencën e një gjykate të rrethit, ku gjyqtari ose prokurori ushtron funksionet e tij ose i ushtronte në momentin e ngjarjes, janë në kompetencën e gjykatës që ka kompetencën lëndore dhe ndodhet në qendrën e një rrethi tjetër më të afërt, me përjashtim të rasteve kur në këtë rreth gjyqtari ose prokurori ka ardhur më pas për të ushtruar funksionet e tij. Në rastin e fundit është kompetente gjykata e një rrethi tjetër më të afërt me atë, në të cilën gjyqtari ose prokurori ushtronte funksionet e tij në momentin e kryerjes së veprës penale.*

Pra, nisur nga fakti se hetimi penal shtrihej dhe ndaj një gjyqtareje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, znj. P.F., dukej se nga subjekti, gjatë fazës së vlerësimit të kallëzimit dhe të hetimit të kryer, nuk është mbajtur parasysh dispozita e nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale. Bazuar në vendimin e pushimit rezultoi në dukje se nga subjekti nuk janë ndjekur të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për këtë çështje, nuk janë pyetur personat që kanë hartuar dhe nënshkruar dy vendimet për të cilët njëri nga këto rezultonte i falsifikuar, si dhe një sërë veprimesh të tjera procedurale që do të çonin në përfundimin e plotë të hetimeve. Nuk rezultoi të jetë pyetur as personi kryesor i kësaj çështjeje, që është gjyqtarja e çështjes, për të konfirmuar dhe për të provuar vendimin e saktë gjyqësor të dhënë dhe të zbardhur nga kjo gjyqtare.

Për sa më sipër dhe nisur nga fakti se Komisioni dispononte vetëm vendimin gjyqësor për këtë çështje, kërkoi shpjegime të hollësishme, shoqëruar dhe me dokumentacion shkresor provues, për hapat e ndjekur nga subjekti lidhur me veprimet hetimore të kryera deri në pushimin e kësaj çështjeje, si dhe lidhur me këto gjetje të Komisionit.

Lidhur me këto konstatime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe dha përgjigje edhe gjatë seancës dëgjimore, bazuar në pyetjet e bëra nga trupi gjykues i Komisionit.

*Subjekti shpjegoi se Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 17.1.2012 ka regjistruar kallëzimin penal të bërë nga shtetësja D. P. lidhur me pretendimin për falsifikim të dokumenteve, pasi denoncueses i ka rënë në dorë një kopje e një vendimi të Gjykatës Elbasan, i së njëjtës datë, me të njëjtin numër vendimi, për të njëjtin ish-pronar, me parcela të njëjta, por që sipërfaqet e shprehura për këto parcela ndryshonin.*

*Kallëzimi nuk i është atribuar gjyqtarës P.F., por flet për falsifikime të kryera për pronat e përfituara me të padrejtë nga shtetasi P.T., dhe se kërkon zbardhjen e ngjarjes, mbi ekzistencën e dy vendimeve gjyqësore me të njëjtin numër dhe datë, por në të cilat, në pjesën e dispozitivit, ndryshonte vendimi.*

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e veta theksoi faktin se kishte filluar menjëherë hetimin për këtë çështje, si dhe ka kryer një sërë veprimesh procedurale<sup>5</sup>.

Duke i konsideruar të plota hetimet, me vendimin datë 23.4.2012, subjekti kishte vendosur pushimin e çështjes penale, duke pasqyruar dhe arsyetimin e saj<sup>6</sup>.

Në lidhje me gjetjen për vlerësimin e kompetencës subjekti sqaroi se në bazë të nenit 78 kompetenca për procedimin penal caktohet në momentin kur personi merr cilësinë e të pandehurit, kjo bazuar dhe në praktikën e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarja P. F. nuk ka qenë asnjëherë në pozitën e të pandehurit.

Lidhur me mungesën e pyetjes së disa personave, subjekti sqaroi se gjatë kohës së ushtrimit të ndjekjes penale ka menduar dhe vlerësuar se në mungesë të vendimit në origjinal gjyqësor me sipërfaqe më të vogël dhe mospërputhjes së tij me të dhënat që gjendeshin në dosje, nuk do të më ofrohej ndonjë e dhënë me interes për hetimin.

Komisioni, pas analizimit të këtij denoncimi dhe përgjigjeve bindëse të sjella nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se nuk rezultuan indice apo prova lidhur me shkelje të subjektit në aspektin e vlerësimit profesional.

### **Në përfundim:**

Mbështetur në raportin e vlerësimit profesional për çështjet e shortuara dhe denoncimet e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

---

<sup>5</sup> Shiko shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit faqe 13 deri 27.

<sup>6</sup> Shiko shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit faqe

Në vlerësimin lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, nuk rezultoi të jetë gjetur ndonjë problem mjaftueshëm i rëndësishëm që do të çonte në një vlerësim aftësish profesionale më pak ose ndryshe nga ai “i përshtatshëm” sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të vlerësimit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

### **A. Për vlerësimin e pasurisë**

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave privatë, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla, ku zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit e justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokurore.

### **B. Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i

rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58; si dhe nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Millonai.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.6.2019.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela Qirko**  
**Kryesuese**

**Brunilda Bekteshi**  
**Anëtare**

**Roland Ilia**  
**Relator**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*